



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja Nr. 91

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302

Prishtinë, më 14 Shkurt 2014, në orën 11:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Hamza Balje, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaqi, Nazane Breca dhe Gëzim Kelmendi.

Mungoi: Faton Topalli.

Të pranishëm: Shaip Muja - Deputet, Arianit Jakupi - Kryeshef i Agjencisë së Kosovës për Produkte Medicinale, Shpresa Haxhijaj - Kordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi - Zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, Kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

RENDI DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës: 04.02.2014;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale;**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi,** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës: 04.02.2014.

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së datës: 04.02.2014.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale.

Fikrim Damka - Tha do të vazhdojmë me shqyrtimin dhe miratimin e amendamenteve të projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale. Si komisioni e kemi shqyrtuar dhe punuar një kohë të gjatë në këtë projektligj edhe në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë respektivisht me Kryeshefin e AKPPM-së, ku kemi propozuar disa amendamente. Po ashtu kemi shqyrtuar edhe disa amendamente të deputetit Shaip Muja, të cilin e falënderojmë për kontributin që ka dhënë në këtë projektligj. Ne si komision në mbledhjen e kaluar kemi mbete te neni 4, që ka të bëjë me Agjencinë për Produkte dhe Pajisje Medicinale se nën ombrellën e kujt do të jetë në të ardhmen. Ne si komision në mbledhjen e kaluar jemi pajtuar që të marrim edhe opinionin e kryeshefit të AKPPM lidhur me këtë çështje. Atëherë fillimisht kërkojmë nga z. Arianit Jakupi Kryeshef i Agjencisë së AKPM-së, që të deklarohej rreth çështjes së AKPPM, a është më mirë që të vazhdoj të funksionoj përsëri në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë apo të kaloj te Zyra e Kryeministrit, siç propozon deputeti Shaip Muja.

z. Jakupi e keni fjalën, fillimisht nëse keni mundësi të na prezantoni shkurtimisht si është duke funksionuar për momentin AKPPM, dhe nëse kalon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit a do të funksionoj më mirë .

Arianit Jakupi – Faleminderit, fillimisht do të filloj me pyetjen e parë se si ka funksionuar deri me tani AKPPM. Në vitin 1999 është formuar Autoriteti Rregullativ i Barnave në Kosovë, i cili është formuar në kuadër të Departamentit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, kurse në vitin 2000 në baze të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/200, përsëri në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë është bërë themelimi i AKPM-së me kompetencat të cilat kanë qenë të përcaktuara në atë kohë. Pastaj është miratuar Ligji Nr. 2003/26, ku me këtë ligj përsëri është përcaktuar që AKPPM të funksionoj në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, po ashtu edhe me Ligjin Nr. 03/L-188, për produkte dhe pajisje medicinale, AKPPM është përcaktuar që të funksionoj në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Tani e pesë muaj jam si kryeshef i AKPPM-së, dhe punët janë duke vazhduar mirë me një rrjedhë normale dhe nuk kemi pas pengesa nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Mbetet që Kuvendi të vendosë se ku do të jetë në të ardhmen AKPPM, pasi që ka praktika të ndryshme sa i përket se si operojnë Agjencitë e barnave. Kemi shtete ku Agjencia funksionon si e pavarur nga Qeveria dhe është në kuadër të Kuvendi, ose në disa shtete janë institucione publike, kurse në shumicën e vendeve janë në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, kështu që kemi përvoja të ndryshme. Nuk ka ndonjë rregull specifik ku përcaktohet qartë se Agjencia duhet të jetë në kuadër të këtij apo atij institucioni. Mbetet që ju të vendoseni se ku do të jetë në të ardhmen AKPPM. Edhe në vendet e regjionit Agjencia është në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë si në Kroaci, Maqedoni Shqipëri etj.

Fikrim Damka – Tha se si komision kemi pranuar një propozimin nga deputeti Muja, që AKPPM të jetë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, për shkak të funksionimit më të mirë dhe më të pavarur nga Ministria e Shëndetësisë. Ja japim fjalën deputetit Muja që të prezanton propozimin e tij.

Shaip Muja - Tha se propozoj që AKPPM të jetë organ i pavarur i cili ekzekuton politikat e Ministrisë së Shëndetësisë por që nuk është organ ekzekutiv i Ministrisë së Shëndetësisë, pra AKPPM duhet të jetë Agjenci e pavarur që implementon politikat e Ministrisë së shëndetësisë, mirëpo të jetë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Nazane Breca – Tha se ne disa herë e kemi diskutuar këtë çështje, në shumicën e shteteve ky organ është në kuadër të Ministrisë përkatëse, po ashtu në Kosovë kemi shumë Agjenci që janë në kuadër të Ministrisë përkatëse. Nuk vërej ndonjë problem se edhe AKPPM të vazhdoj të funksionoj në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Nuk mund të bëjmë eksperimente që AKPPM të kaloj në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ku ka edhe implikime buxhetore, kështu që unë jam që AKPPM të vazhdoj të jetë në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

Time Kadriaj – Tha se nëse në të ardhmen rregullohet me ndonjë akt se të gjitha Agjencitë do të kalojnë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, le të kalon edhe AKPPM, mirëpo unë tash për tash jam që të vazhdoj të jetë në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

Gëzim Kelmendi – Tha se edhe unë jam pro që AKPPM të vazhdoj të jetë në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Çdo deputet ka të drejt të jep rekomandime për amendamente nëse kalon në komision mire nëse jo mundet edhe vet të propozoj të votohet në seancë për propozimet, ne të vazhdojmë me çështjet tjera.

Fikrim Damka – Tha se edhe unë jam pro që AKPPM, duhet të vazhdoj të funksionoj në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

Hamza Balje –Tha se edhe unë jam pro që AKPPM të jete në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

Flora Brovina – Tha se edhe unë jam pro që AKPPM të vazhdoje të funksionoj në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

Salihe Mustafi – Tha se A ka staf profesional zyra e kryeministrit të mbikëqyrë AKPPM –në, kurse në këtë rast Ministria e Shëndetësisë e ka stafin dhe qasjen më të lehtë të mbikëqyrë funksionimin e AKPPM-së.

Bahri Thaqi – Tha se edhe unë jam pro që AKPPM të jetë në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

Fikrim Damka – Tha se diskutuam mjaftë rreth kësaj çështje, të vazhdojmë më tej, kemi diskutuar edhe mbledhjen e kaluar dhe si po shihet nga diskutimet të gjithë anëtarët e Komisionit jemi që AKPPM të jetë në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë ashtu si është propozuar në Projektligj.

Pas diskutimit të gjithë anëtarët e Komisionit u pajtuan që neni 4 , të mos ndryshohet dhe AKPPM të funksionoj në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

Fikrim Damka – Tha të vazhdojmë me shqyrtimin dhe miratimin e amendamenteve të propozuara nga grupi punues :

***Komisioni,** Pas shqyrtimit dhe miratimit të amendamenteve veç e veç, Komisioni miratoi njëzëri amendamentet në Projektligjin për Produkte Medicinale dhe Pajisje Medicinale dhe raporti me amendamente procedohet më tej te komisionet e përhershme.*

4. Të ndryshme.

Kryetari, pyeti se a ka dikush diçka për të shtuar tek pika të ndryshme?Pasi nuk ka atëherë e mbyllim takimin, faleminderit të gjithëve.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka